



# Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

**KUMTESË PËR MEDIA**  
**6 MARS 2018**

## **RrGK reagon pas lirimit të të akuzuarit kryesor për vrasjen e Donjeta Pajazitit**

Sot, me datë 6 mars 2018, përmes mediave lokale Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) u njoftua për lirimin e të akuzuarit kryesor për vrasjen e Donjeta Pajazitit. Në deklaratat e po këtyre medieve thuhej se i akuzuari është liruar nga akuza për vrasje të rëndë ngase nuk ka prova se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Ju rikujtojmë që e ndjera ishte shpallur e zhdukur për gjashtë javë, ndërsa trupi i saj i pajetë u gjet në bjeshkët e fshatit Strellc në dhjetor të vitit 2015. Në atë kohë, RrGK dhe Lobi i për Barazi Gjinore patën reagu, duke kërkuar nga institucionet e drejtësisë të hetojnë rastin dhe të gjejnë vrasësin e të ndjerës.

RrGK dhe në përgjithësi shoqëria kosovare janë dëshmitarë të dështimeve të sistemit të drejtësisë në zbardhjen e rasteve të vrasjeve të grave dhe vajzave.

Prandaj, përmes këtij reagimi RrGK përsëri u bën thirrje institucioneve të drejtësisë të vazhdojnë hetimin në lidhje me vrasjen e Donjeta Pajazitit. RrGK beson që vetëm me vendime të drejta organet e drejtësisë mund të ndikojnë në uljen e dhunës, respektivisht krimit. Ngritja e përgjegjësive institucionale gjatë trajtimit të dhunës me bazë gjinore do të rrisë raportimin e këtyre rasteve, duke u siguruar të ketë drejtësi, mbrojtje dhe rehabilitim për rastet e dhunës me bazë gjinore.

*Rrjeti i Grave të Kosovës është rrjet i 126 organizatave të ndryshme të të drejtave të grave në gjithë Kosovën që synon të mbrojë, promovojë dhe mbështesë të drejtat e grave dhe vajzave.*